Kronikë

Atentat në autostradën Vlorë-Fier, vritet 30-vjeçari me të shkuar kriminale! Dyshohet për 3 autorë, dogjën automjetin e krimit dhe u arratisën me tjetër (EMRI+VIDEO)

Një atentat ka ndodhur mbrëmjen e sotme në autostradën Vlorë-Fier, ku një 30-vjeçar është ekzekutuar me pistoletë tip "Glock" në afërsi të fshatit Novoselë. Drejt 30-vjeçarit Marku, fillimisht rezulton të jetë qëlluar pranë një vendndalimi të autostradës, ku dhe janë gjetur 9 gëzhoja, ndërsa një gëzhojë e 10 është gjetur në makinën e viktimës, e cila ishte e ndaluar rreth 1 kilometra poshtë vendpushimit. Policia ka sekuestruar kamerat e sigurisë në bizneset afër zonës ku ka ndodhur ngjarja, si dhe ka shoqëruar disa persona.

- U ekzekutua në Novoselë, viktima ishte nip i Martin Bardhit të vrarë në shtator 2023 më Rrëshen
- Policia gjen 10 gëzhoja në vendin e ngjarjes
- Atentati ndaj 30-vjeçarit në autostradën Vlorë-Fier, makina e autorëve në flakë duke u djegur (VIDEO)

Redaksia
13 Janar, 18:59 | **Përditesimi: 13 Janar, 21:28**

Share

VLORË - Një atentat ka ndodhur mbrëmjen e kësaj të hëne (13 janar 2025) në autostradën Vlorë-Fier, ku një 30-vjeçar është ekzekutuar me pistoletë tip "Glock" në afërsi të fshatit Novoselë.

Viktima i identifikuar si Kristian Marku mësohet se po lëvizte me makinë tip "Volkswagen".

Drejt 30-vjeçarit Marku, fillimisht rezulton të jetë qëlluar pranë një vendndalimi të autostradës, ku dhe janë gjetur 9 gëzhoja, ndërsa një gëzhojë e 10 është gjetur në makinën e tij, e cila ishte e ndaluar rreth 1 kilometra poshtë vendpushimit.

LEXO EDHE:
Rama në Romë, merr pjesë në prezantimin e 'Giro d'Italia', kryeministri: Sporti italian ka pasur influencë të jashtëzakonshme në Shqipëri! Tajani: Gati t'ju presim në BE

Këto rrethana kanë ngritur dyshimet se mos Kristian Marku është qëlluar teksa ka qenë i ndaluar në vendndalimin e autostradës dhe ka tentuar të largohet, apo se është qëlluar në lëvizje e sipër.

Në pamjet e siguruara nga Report Tv, duket se automjeti i viktimës ka dëmtime që duken të fituara nga përplasja me barrierat e autostradës, ç'ka përforcon tezën e dytë për të shtëna në lëvizje e sipër.

Nga hetimet e deritanishme dyshohet se kanë qenë 3 autorë dhe kanë përdorur një makinë tip "Benz", të cilën e kanë djegur rreth 2 kilometra larg vendit të krimit dhe janë ndihmuar nga persona të tjerë për t'u arratisur. Makina e djegur rezulton me targa të vjedhura dhe brenda saj nuk është gjetur arma e krimit. Ata dyshohet se mund të jenë larguar drejt Fierit duke përdorur rrethrrotullimin e Panajasë.

Policia ka sekuestruar kamerat e sigurisë në bizneset afër zonës ku ka ndodhur ngjarja, si dhe ka shoqëruar disa persona.

> *"Rreth orës 18:15, në afërsi të fshatit Novoselë, në autostradën Fier-Vlorë, është qëlluar me armë zjarri në drejtim të një automjeti tip "", me drejtues shtetasin K. M., 30 vjeç, i cili ka humbur jetën",- njoftoi policia më herët.*

Kush ishte Kristian Marku?

Kristian Marku alias Kristi Bardhi është nga Mirdita dhe rezulton të jetë nipi i Martin Bardhit të vrarë në Rrëshen, në shtator të vitit 2023. 30-vjeçari dyshohet të jetë autor në ngjarjen e datës 26.03.2023, rreth orës 19:00, të ndodhur në Rrëshen, Mirditë, ku pati të shtëna me armë zjarri në drejtim të Saimir Reçit.

Ai akuzohej për veprat penale "Vrasje me dashje në bashkëpunim mbetur në tentativë" dhe "Mbajta pa leje e armëve të zjarrit dhe municionit luftarak", por nuk u arrit të provohet përfshirja e tij në këtë ngjarje dhe arriti të fitojë lirinë.

Në vendngjarje kanë shkuar shërbime të Policisë së DVP Vlorë dhe grupe të Forcës Kombëtare të Sigurisë Njësia Fier. Vijon krehja e zonës dhe kontrollet për kapjen e

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com autorëve.

Është ngritur një grup i posaçëm hetimor dhe, nën drejtimin e Prokurorisë, vijojnë intensivisht hetimet për zbardhjen e rrethanave dhe sigurimin e provave, me qëllim dokumentimin ligjor të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Lajmi në përditësim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 21:24

Atentati në Novoselë, ja momenti kur transportohet makina e viktimës

Report Tv ka siguruar pamje nga makina e viktimës, 30 vjecarit Kristian Marku, i cili u qëllua me pistoletë mbrëmjen e sotme teksa ishte duke lëvizur me mjetin e tij, në autostradën Vlorë-Fier, në afërsi të fshatit Novoselë.

Makina e 30 vjeçarit, i cili u qëllua nga persona që ende janë të paidentifukuar, duket e dëmtuar në pjesën e përparme të saj.

S.B/Shqiptarja.com

Share

Ora 20:10

U ekzekutua në Novoselë, Kristian Marku ishte nip i Martin Bardhit të vrarë në shtator 2023 më Rrëshen

Kristian Marku u vra sot në një atentat Novoselë, në autostradën Vlorë-Fier. Siç bëhet me dije Marku është nipi i Martin Bardhit të vrarë në shtator të vitit 2023, në Rrëshen.

Martin Bardhi u ekzekutua me armë zjarri paraditen e 26-shtatori 2023 teksa po pinte kafe në lokalin në pronësi të tij në Rrëshen.

Nga breshëria e plumbave mbeten të plagosur dhe tre persona të tjerë të cilët ishin nën shoqërinë e viktimës, ndërsa autoret e ngjarjes ishin dy persona të maskuar të cilët u larguan me një foristradë e cila u gjet e djegur në fshatin Gziq të Mirditës.

Vrasja e Bardhit është dyshuar të ketë lidhje me një konflikt të mundshëm me familjen Reçi, megjithatë të pyetur nga policia këta të fundit e mohuan një lidhje të tillë.



Martin Bardhi

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 20:04

Policia gjen 10 gëzhoja në vendin e ngjarjes, viktima me precedentë për vrasje të mbetur në tentativë

Burime për Report tv bëjnë me dije se ndaj 30 vjeçarit Kristian Marku është qëlluar me pistoletë. Policia në vendin e ngjarjes ka gjetur 9 gëzhoja në vendngjarje dhe 1

tjetër disa metra më poshtë.

30-vjeçari i vrarë rezulton me origjinë nga Rubiku dhe me precedent penal për "vrasje me dashje ne bashkepunim mbetur ne tentative" dhe "Mbajtja pa leje e armëve të zjarrit dhe municionit luftarak".

S.B/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:54

Atentati ndaj 30 vjeçarit, dyshohet se ishin 3 autorë, u larguan drejt Fierit

Detaje të reja kanë dalë, lidhur me atentatinë e ndodhur mbrëmjen e sotme, ku u qëllua me pistoletë në drejtim të makinës se Kristian Markut.

Burime për Report Tv, bëjnë me dije se autorët, të cilët e kanë zënë në pritë, kanë qenë me një makinë tip "Benz" dhe i janë afruar makinës së 30-vjeçarit duke qëlluar.

Pas vrasjes autorët, të cilët dyshohet se ishin tre, kanë djegur automjetin "Benz" dhe janë ndihmuar nga persona të tjerë për t'u arratisur.

Ata dyshohet se mund të jenë larguar drejt Fierit duke përdorur rrethrrotullimin e Panajasë.

S.B/Shqiptarja.com

Share

Ora 19:31

Atentati ndaj 30-vjeçarit në autostradën Vlorë-Fier, makina e autorëve në flakë duke u djegur (VIDEO)

Pas atentatit të ndodhur mbrëmjen e sotme në autostradën Vlorë-Fier, ku 30-vjeçari Kristian Marku u ekzekutua teksa ishte duke drejtuar mjetin e tij "Volkswagen", është gjetur edhe një makinë e djegur.

Report Tv ka siguruar pamjet nga makina që dyshohet e autorëve, pak metra më larg vendit ku ndodhi atentati.

S.B/Shqiptarja.com

Share

K.M/Shqiptarja.com

TAG: Kristian Marku | Martin Bardhi | Vlore | vrasje | novosele

Komento

Komente

Beni: 13/01/2025 20:36

Kemi police te korruptuar por ka dhe te ndershem dhe te afte plot por te kerkosh qe policia te kap autoret direkt mbas nje vrasje kjo eshte dhe lajthitje nga disa trapa , keshtu qe kur komentoni vini pak llogjiken ne pune

Përgjigju

Partia: 13/01/2025 20:35

Po cna duhen vrasjet, ca u be me vllain e me te madhit, ajo na duhet ne, jo rend e drejtesi.

Përgjigju

O komentus: 13/01/2025 20:21

Ska asnje lidhje ky me vis martinin, mos folni kot ky esht na hardhajt e mirdites ne hasmeri me rect

Përgjigju

Shperthyesi: 13/01/2025 20:08

Spo mbahen me, kane fillu vrasjet per qejf te k... Policia gjume, mbledh te vraret dhe kreh leshte e zones

Përgjigju

Rrapo: 13/01/2025 20:04

Fajin e Ka saliu

Përgjigju

Land rover: 13/01/2025 20:04

Ca lajmin policia ne kerkim autorete Ca kerkim leshi u albanistan

Përgjigju

Alb: 13/01/2025 19:52

vrasje ne fier tani duhet me ngrit nje postobllok ne shkoder vaj medet ca shteti han buken kot uniformat e rendit

Përgjigju

Tarrasi: 13/01/2025 19:50

Bravo Rama.....

Përgjigju

Bosi: 13/01/2025 19:47

Ky eshte ushtari i hatos,me shum mundesi ka marr pjes te ajo ne shkoder

Përgjigju

Dobrac: 13/01/2025 20:34

CA lidhni gjithca me njat ngjarje

Oo legena: 13/01/2025 20:14

Prap fillut ju me hedh kunja

G bani: 13/01/2025 19:45

Mbeturinat e vis martinit. Yyyt malok rrac e keqe. Bythkak zhulsa qelbsina

Përgjigju

Biku: 13/01/2025 19:39

O hundlesha, ka gjithmon nje hundlesh me hundlesh se ju. Mos harroni

Përgjigju

Rrrrrrrr: 13/01/2025 19:17

Perdite nga 1 i vrare.ndaj ikin njerezit nga ky vend se jeta e robit nuk vlen as sa 1 pule

Përgjigju

Lala: 13/01/2025 20:04

Kudo vriten perdite.e vriten ATA QE u ha Suma.

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës: 13 Janar, 10:25

Nisi regjistrimi, a do të marrë pjesë masivisht në zgjedhje diaspora?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

U arrestua në Slloveni për vrasjen e ukrainasit në Itali, 40-vjeçari shqiptar një ushtarak karriere! Pistat për krimin, precedentët dhe identitetet e rreme

13 Janar, 17:14

Përmbytje në Vlorë/ Tërhiqet uji nga lagjet kryesore mbetet në oborret e banesave në periferi! Rënie dherash në aksin Himarë-Kuç

Armand Xhelili

13 Janar, 09:06

Vritet kryebashkiaku në Ekuador, u qëllua teksa ishte në makinë me djalin, plagoset i mituri

13 Janar, 07:46



Përmbytjet në Vlorë, banorët vendosin thasët me rërë për të ndaluar ujin! Dredha: Përveç 'Albano & Romina', rrugët e tjera të kalueshme (VIDEO)

12 Janar, 22:44

Përmbytjet në Vlorë, ministri i Mbrojtjes: Po angazhohemi për menaxhimin e situatës (VIDEO)

12 Janar, 22:31

Tiranë/ Atentat te Pallati me Shigjeta, vritet në makinë 56-vjeçari, po hynte në banesë! Autori ishte maskuar me kapuç, iku me motor drejt Selitës (EMRI+VIDEO)

Sokol Dema

12 Janar, 20:58



Përmbytet sërish Vlora / 'Albano & Romina' e disa rrugë të pakalueshme, uji ka hyrë në disa banesa! Qytetarët vendosin thasët me rërë (VIDEO)

12 Janar, 18:29

REPORTAZH/ Mbetur në harresë, braktiset Lapardhaja e Vlorës! Banorët: Prej '90-ës s'kemi rrugë as ujë, veç premtime

Armand Xhelili

12 Janar, 14:48

VIDEO/ Vlorë, policia mësyn pallatet në ndërtim tek '28 Nëntori', në kërkim të hajdutit! Ndërhyn dhe FNSH

Armand Xhelili

12 Janar, 14:41

VIDEOLAJM/ Orikum, peshkaqeni 'dhelpër' 3.5 m i gjatë del në breg të detit! Habiten banorët

12 Janar, 11:09

Moti i Keq/ Vendi përfshihet nga shiu e bora, bllokohet bypass i Murrizit e 'Rruga e Arbrit', edhe Vlora nën ujë! Pezullohet mësimi në 77 shkolla

12 Janar, 08:34

Atentati në Vlorë më 18 dhjetor, dëshmon Kevin Hajrulla: Nuk kam konflikte me njeri! Inezin e kam kushëri, por kontaktet i kemi të rralla

Armand Xhelili

11 Janar, 18:45

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje